



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Mehanizmi Parandalues Nacional, më datë 14.11.2014, realizoi vizitë jashtë radhe në Qendrën për Pranimin e të Huajve dhe për të njëjtën dërgoi Informatë deri te ministria kompetente, me qëllim të ndërmarrjes së masave të cilat do të mundësojnë respektimin e të drejtës së kërkimit të azilit, trajtimit human me personat gjatë periudhës së ndalimit të tyre të përkohshëm, vendosjes alternative të fëmijëve dhe grave, si dhe sigurimit të kushteve humane të strehimit të migrantëve të tjerë ilegalë, përmes dislokimit të institucionit në objekt i cili do t'i mundësojë parakushtet e kërkua.

Në ditën e vizitës kishte gjithsej 264 persona, nga të cilët 29 femra dhe 19 të mitur të shoqëruar, si dhe 17 të mitur të pashoqëruar. Numri i personave është mbi kapacitetin të lejuar. MPN-ja, gjatë kësaj vizite, konstatoi se në Qendrën për Pranimin e të Huajve nuk janë përmbushur standardet e dëshiruara. Standardet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës parashikojnë sigurimin e ambienteve të pajisura me mobilie përkatëse, të cilët duhet të jenë të pastër dhe të mirëmbajtura, me sipërfaqe të mjaftueshme hapësinore për personat të cilën qëndrojnë aty. Standardet ndërkombëtare imponojnë që personat të mos vendosen në kushte substandarde, ndërsa kushtet e vendosjes, në mënyrë plotësuese, mund të jenë edhe shkak për trajtim johuman, në përputhje me nenin 3 të KEDNJ.

Gjatë vizitës u pranuan ankesa në lidhje me trajtimin johuman ndaj migrantëve ilegalë, përkatësisht përdorimin e forcës në raste ku nuk kanë bazë. Si problem u potencua edhe sasia e pamjaftueshme e ushqimit, i cili jepet në Qendër, si dhe mospajtimi i veshëmbathjes joadekuate, e cila do t'i përshtatej motit, duke e marrë parasysh ngrohjen e cila nuk funksiononte gjatë kohës së vizitës.

Sikurse edhe gjatë vizitës paraprake edhe tani u konstatua se nuk zbatohet në mënyrë të njëjtë dispozita për sigurimin e shëtitjes në ambient të hapur, dy herë në ditë, me kohëzgjatje prej një ore për personat e huaj ose gjithsej dy orë, për shkak se objekti nuk ka rrethim të sigurt dhe nuk ka hapësirë të mjaftueshme për realizimin e kësaj të drejte për të gjithë personat e vendosur në Qendër.

Mbrojtja e grupeve vulnerable në Qendër, përkatësisht e fëmijëve dhe grave, edhe më tej është e pamjaftueshme. Rregullat dhe standardet ndërkombëtare për kategoritë vulnerable sugjerojnë se mbyllja e këtyre kategorive të personave në qendra të llojit të mbyllur duhet të jetë përjashtim dhe të reduktohet në periudhë sa më të shkurtër të mundshme.

Gjatë kohës së vizitës u vërejt se ekziston mbipopullim i kapaciteteve si tek gratë ashtu edhe tek fëmijët, të njëjtët nuk kanë ngrohje përkatëse, e as veshmbathje adekuate. Duke i marrë parasysh rekomandimet e trupave ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve dhe shmangien e mbylljes në qendrat speciale për migrantë, në drejtim të interesit më të mirë të fëmijëve, qëndrimi i fëmijëve duhet të jetë në kushte adekuate, në të cilat do të kenë ndihmë përkatëse sociale, mjekësore dhe psikologjike. Në mënyrë plotësuese, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës 2020 (2014), më datë 03.10.2014, rekomandoi pengimin e ndalimit dhe privimit nga liria të fëmijëve migrantë ilegalë dhe gjetjen e modeleve alternative për qëndrim, të cilat do të jenë në drejtim të interesit më të mirë të fëmijëve.